01-1838

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

PRISHTINA

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L - 031 dt.21.07.2016, nenit 17 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L - 040, dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt.25.02.2010, UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 nr. 350 /02 - 224787/19 dt.12.09.2019, të kërkuesve / pronarëve, Isa Berisha, Ymrane Pangja, Avni Berisha, Kujtim Thaçi, "Prime Group Construction"sh.p.k nga Prishtina dhe Investitorit "Prime Group Construction" sh.p.k. nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **Kompleksi *"Prime City 04"***, me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Lam. "A", "B", "C"**, në kuadër të Bllokut urban "E-11", Tërësia hapësinore "E" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt për vendosjen e çështjes administrative, me datë 20.01.2020 merr këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore kërkuesve / pronarëve, Isa Berisha, Ymrane Pangja, Avni Berisha, "Prime Group Construction"sh.p.k, Kujtim Thaçi, nga Prishtina dhe Investitorit "Prime Group Construction" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810046781 dhe me përfaqësues Teki Bujupi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr. 350 /02 - 224787/19 dt.12.09.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **Kompleksi *"Prime City 04"*,** me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Lam. "A", "B", "C"** në kuadër të Blloku urban "E11", Tërësia hapësinore "E", të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të kompleksit të formuar nga parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale: nr. 1830-1, 1830-2, 1830-3, 1830-4, 1830-11 & 1830-12 ZK Prishtinë, si dhe me trajtimin përmes transferit (kompensimit me sipërfaqe ndërtimore) të pjesëve të parcelave kadastrale, nr.10204-1, 1818-3, 1814-1 ZK Prishtinë.

II. Lokacioni me parcelat kadastrale për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës 01 nr.35 -186850 dt.02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e destinuar "Mikse – kryesisht rezidncial" gjegjësisht ndërtim shumë banesor rezidencial & afarist, si dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01nr.035-181427 dt. 24.09.2013.

Për parametrat, kriteret urbane dhe kushtet e ndërtimit të planit rregullues, kërkuesit janë informuar përmes "Web faqja" zyrtare të Komunës së Prishtinë, në cilën janë të postuara dokumentet e planifikimit hapësinor, konkretisht edhe Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" dhe Plani Zhvillimor Urban.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit-parcelave kadastrale : nr. 1830-1, 1830-2, 1830-3, 1830-4, 1830-11,1830-12, nr. 10204-1, 1818-3, 1814-1, ZK Prishtinë, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe planifikimit urban, është:

- Sipërfaqet e parcelave kadastrale dhe pronarët e tyre, sipas certifikatës së njësisë kadastrale, janë:

- nr.1830-1, me S=500m² dhe pronar Avni Berisha; ....."Arë e klasit 4";
- nr.1830-2, me S=368m² dhe pronar Avni Berisha; ..... "Arë e klasit 4";
- nr.1830-3,me S=1000m² dhe pronar "Prime Group Construction"sh.p.k.,..... "Arë e klasit 4";

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- nr.1830-4, me S=1000m² dhe pronar Ymrane Pangja; ..... "Arë e klasit 4";
- nr.1830-11, me S=400m² dhe pronar Isa Berisha;..... "Arë e klasit 4";
- nr.1830-12, me S=400m² dhe pronar Avni Berisha;..... "Arë e klasit 4";
- nr.10204-1, me S=883m² dhe pronar "Prime Group Construction"sh.p.k.;..... "Rrugë";
- nr.1818-3, me S=722m² dhe pronar Kujtim Thaçi;..... "Kullosë e klasit 3";
- nr.1814-1, me S=500m² dhe pronar "Prime Group Construction"sh.p.k.;..... "Arë e klasit 5";

Sipërfaqe totale S=5,773.00m²;

- E drejta pronësore-juridike e parcelave të lartcekura është private, në bazë të certifikatave të njësive kadastrale;
- Parcelat kadastrale të lartcekura, bazuar në planin "Riparcelimi" i Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", përfshihen në kuadër të parcela & pjesë të parcela ndërtimore "E11-1", të Blloku urban "E11";
- Është tokë urbane me infrastrukturë të planifikuar: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj;
- Bazuar në gjendjen faktike dhe incizimin gjeodezik të lokacionit, në kuadër të parcelave kadastrale të trajtuara, nuk ka ndërtesa të ndërtuara, gjegjësisht parcelat janë të zbarazëta;
- Lokacioni - terreni ka pjerrtësi nga drejtimi jug – veri dhe lindje – perëndim,;
- Parcelat kadastrale të lartcekura kanë qasje në rrugën lokale të lagjes (rr.Artim Jashari), gjegjësisht përmes parcelës kadastrale nr.10204-1 ZK Prishtinë, e cila është edhe rrugë e planifikuar e planit rregullues ;

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projekti kryesor, për realizimin / ndërtimin e **Kompleksi *"Prime City 04"***, me ndërtesa shumë banesore & afariste – Lam. "A", "B", "C", në kuadër të **Parcela ndërtimore *"E11-1"***, Bllokut urban "E-11", Tërësia hapësinore "E", të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" në Prishtinë, janë:

- Organizimi me qasje në kompleks, shtrirja e kompleksit, gabaritet & etazhiteti i ndërtesave, pozicionimi i tyre në raport me vijën rregulluese, ndërtimore dhe kufiri i parcelave, distanca në mes ndërtesave dhe nga kufiri i parcelave ndërtimore, rrugët, shtigjet dhe vendparkimet e kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik në Plani i lokacionit – "zgjidhja urbane", bashkëngjitur këtyre kushteve ndërtimore;
- Parcelat & pjesët e parcelave kadastrale, të trajtuara në **Kompleksi *"Prime City 04"***, me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Lam. "A", "B", "C"**, gjegjësisht parcelave kadastrale të trajtuara brenda vijës rregulluese, është:
  - nr.1830-1, me S=408m²;
  - nr.1830-2, me S=352m²;
  - nr.1830-3, me S=1000m²;
  - nr.1830-4, me S=983m²;
  - nr.1830-11, me S=400m²;
  - nr.1830-12, me S=400m²;
  - nr.10204-1, me S=185m²;
  - nr. 1814-1, me S=0.00m²;
  - nr.1818-3, me S=0.00m²;

  Sipërfaqe totale S=3,728.00m²;
- Parcelat & pjesët e parcelave kadastrale dhe sipërfaqet e trajtuara me **Kompleksi *"Prime City 04"***, me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Lam. "A", "B", "C"** që përfshihen jashtë **Parcela ndërtimore *"E11-2"***, gjegjësisht jashtë vijës rregulluese, janë:
  - nr.1830-1, me S=92m²;
  - nr.1830-2, me S=16m²;
  - nr.1830-3, me S=0.00m²;
  - nr.1830-4, me S=17m²;
  - nr.1830-11, me S=0.00m²;
  - nr.1830-12, me S=0.00m²;
  - nr.10204-1, me S=63 + 63=126m²;
  - nr.1818-3, me S=168m²;
  - nr.1814-1, me S=190m²;

  Total S=609.00m²,

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Pjesët e parcelave kadastrale me sipërfaqet të cilat nuk do të trajtohen në **Kompleksi *"Prime City 04"*,** gjegjësisht me këto kushte ndërtimore dhe ato janë:
  - nr.1830-1, me S=0.00m²;
  - nr.1830-2, me S=0.00m²;
  - nr.1830-3, me S=0.00m²
  - nr.1830-4, me S=0.00m²
  - nr.1830-11, me S=0.00m²
  - nr.1830-12, me S=0.00m²
  - nr.10204-1, me S=434 + 60 + 78=572m²
  - nr.1818-3, me S=310+244=554m²;
  - nr.1814-1, me S=310m²;

  Total S=1,436.00m²,
- Në **Kompleksi *"Prime City 04"*,** në kuadër të **Parcela ndërtimore *"E11-1"***, Blloku urban "E11", Tërësia hapësinore "E" të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", planifikohen ndërtesat shumë banesore & afariste - **Lam. "A", "B", "C"**, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas llogaritjeve dhe projekt propozimit – "zgjidhja urbane", si më poshtë:

  Kompleksi *"Prime City 04"* me **Lam."*A", "B", "C",***
  Lam. "A" – S=3,241.05² / 2,585.05m²,mbi tokë + 656m²,nën tokë /,
  Etazhitet: -**B + S + P + 6**
  Lam. "B" – S=3,380.40m² / 2,562.10m²,mbi tokë + 818.30m²,nën tokë /,
  Etazhitet: -**B + S + P + 6,**
  Lam. "C" – S=4,103.60m² / 2,659.48m²,mbi tokë + 1,444.12m²,nën tokë /,
  Etazhitet: -**2B + P + 6,**
  Totali: S=10,725.04m² / 7,806.60m², mbi tokë + **2,918.42m²,** nën tokë /.
- Destinimi i shrytëzimit të ndërtesave, bazuar në kriteret e planit, është "Mikse – kryesisht rezidncial" gjegjësisht ndërtim shumë banesor rezidencial & afarist,, si dhe me hapësira përcjellëse të ndërtesave: kthina teknike, depo, hapësira garazhuese, etj. (sipas projekt propozimit të prezantuar dhe miratuar);
- Koeficienti i shfrytëzimit i parcelës kadastrale të bashkuara në kompleks (ISHP), brenda vijës rregulluese / parcelës ndërtimore, për vendosjen e ndërtesave në bazë-gabarit të përdhesës ose suterenit dhe etazheve mbi nivelin - katin e parë të ndërtesave të kompleksit, është:

Kompleksi *"Prime City 04"* -Lam."A", "B", "C".
Perdhesë, max.40%, dhe kjo sipërfaqe është:
S=3,728 x 0.4 =1,491.20m²;
S=1,491.80m² /sipas projekt propozimit/
Etazhet mbi nivelin - katin përdhes, është max.30%, dhe kjo sipërfaqe është:
S=3,728 x 0.3=1,118.40m²;
S=1,118.90m² /sipas projekt propozimit /

- Koeficienti i shfrytëzimi të parcelave kadastrale për etazhet e nëntokës (ISHPN) për vendosjen e ndërtesave në bazë – gabarit të bodrumit, bazuar kriteret e planit rregullues dhe paragrafit II. pika 1. të Vendimit 01 nr.031–185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, lejohet max.60% dhe sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, kjo sipërfaqe është:

Kompleksi *"Prime City 04"* - Lam. "A", "B", "C",
Bodrum, max.60%, dhe kjo sipërfaqe është:
S=3,728 x 0.6 =2,236.80m²; / të lejuara sipas planit rregullues & vendimit /
S=1,848.88m²/sipas projekt propozimit/

- Në kuadër të kompleksit të planifikohen edhe hapësira me sipërfaqe gjelbëruese(ISGJ) min.20%, me gjelbërim të lartë, të ultë dhe të organizuara për sport & rekreacion. Sipërfaqet gjelbëruese, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, për kompleksin është:

Kompleksi *"Prime City 04"* - Lam. "A", "B", "C".
Parteri me gjelbërim min.20%, dhe kjo sipërfaqe, është:
S=3,728 x 0.2=745.60m²; / të lejuara sipas planit /
S=1,429.53m²/sipas projekt propozimit/

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

• Koeficienti i ndërtimit (ISPN) bazuar në sipërfaqen e parcelës ndërtimore është - lejohet të jetë max.1.8. Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: ***100%*** për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi ***51%*** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - ***suteren***, dhe ***0%*** për etazhet e nëntokës – ***bodrum***, dhe kjo sipërfaqe është:

Kompleksi *"Prime City 04"* - Lam. "A", "B", "C".

S=3728 x 1.8=6710.40m²; / të lejuara sipas planit brenda parcelës ndërtimore/

• Pasi sipërfaqja e parcelave të përfshira jashtë vijës rregulluese – në hapësirë publike dhe trajtuar me këto kushte ndërtimore tejlakon 20% (609/3728 x 100=16.33%), dhe koeficienti ndërtimor i PZHU-së për këtë hapësirë është 1.8 ÷ 3.0, andaj aplikohet Vendimi 01nr.031-185483 të datës 14.08.2015 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin - transferimin e të drejtave ndërtimore të pronës private, përfshirë në hapësira me interes publik. Ky transferim realizohet me koeficient minimal të ndërtimit të PZHU-së(1.8), pasi raporti i pjesës së jashtëme me ato brenda vijës rregulluese në përqindje është: 609/3728 x 100=16.33%, andaj kjo sipërfaqe prej S=609m² do të kompensohet si në vijim: S=609 x 1.8=1,096.20m². Sipërfaqja totale nërtimore e ***Kompleksi "Prime City 04"*** është: **S=6710.40 + 1,096.20 =7,806.60m²**

• Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë 1.0 x H (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje 0.5 x H ose min. 7m, ku distanca prej 7.0 m vlenë edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore të banesave, etj);

• Distanca në mes të ndërtesave (shumë banesore apo afariste) te fasadat e kombinuara (njëra ndërtesë fasadë ballore, kurse tjetra ndërtesë fasadë anësore) lejohet që distanca të jetë 0.6 x H;

• Etazhiteti maksimal i lejuar në bllokun urban "E11" është P+4, ku ky etazhitet mund të ndryshohet - rritet me aplikimin e Vendimit 01nr.400-660 dt.26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për shpronësimin - kompensimin e pronës private për interes publik, me koeficient të ndërtimit;

• Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016, protokoluar me numrin 01nr.031-185481, për arsye të kursimit dhe efiçiencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e termoizolimit në fasadat e ndërtesës, nuk do të përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISPN), e as në kalkulimin për taksën e lejes ndërtimore;

• Ngritja e nivelit të përdhesës nga niveli i terrenit - trotuarit të ndërtesës, lejohet të jetë max.1.2 m;

• Qasjet në kompleks të jenë nga rrugët e planifikuara në mes Blloqeve urbane "E11" & "E13";

• Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vendparkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret kënde të lojrave për fëmijë, terrene sportive, mobiliar urban, etj.;

• Për çdo njësi banesore-rezidenciale të planifikohet 1.2 vendparkim/një njësi banesore, kurse për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen vendparkimet, për çdo 1000m²/40 vendparkime për shitore, banka, posta dhe të ngjajshme, për çdo 1000m²/20 vendparkime për administratë, për çdo 1000m²/50 vendparkime për ndërtesa hoteliere, për çdo 1000m²/30 vendparkime për ndërtesa kulturore dhe përmbajtje publike, si dhe për salla polifunksionale 20 ulëse / 1 vendparkim;

• Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;

• Arkitektura- dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe masa të efiçiencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

• Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin urban & arkitektonik;

• Aplikimi i kushteve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuar në kriteret dhe parametrat urban të Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim".

V. Ndarja / parcelimi i parcelës kadastrale, nr. 1830-1, 1830-2, 1830-3, 1830-4, 1830-11 &

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

1830-12 ZK Prishtinë si dhe nr. 10204-1, 1818-3 & 1814-1 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas vijës rregulluese që ndan hapësirat publike me hapësirën private të planit rregullues urban, sipas ndarjes së parcelave për shpronësim/kompensim me sipërfaqe ndërtimore, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe Manualit të ndarjes, punuar nga Kompania gjeodezike "GeoHorizont"sh.p.k. nga Prishtina me licencë nr.54.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekura, sipas Manualit i ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Kjo procedurë të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronari & investitorit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori, dhe Manuali i ndarjes punuar nga Kompania gjeodezike e licencuar GeoHorizont"sh.p.k. nga Prishtina me licencë nr.54, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Kjo procedurë do të realizohet në Drejtorin e Kadastrit të Komunës së Prishtinës.

VI. Kompensimi / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i pjesve të parcelës kadastrale, nr.1830-1 me S=92m²; nr.1830-2 me S=16m²; nr.1830-4 me S=17m²; nr.10204-1 me S=126m²; nr.1818-3 me S=168m²; nr.1814-1 me S=190m²; të gjitha me sipërfaqe totale prej, S=609m² të përfshira në hapësira publike - rrugët e planifikuara e planit rregullues, do të mundësohet, për të cilën sipërfaqe pronarët / investitori, do të kompensohen me sipërfaqe ndërtimore, të llogaritur me koeficient ndërtimi të planit rregullues 1.8. Për sipërfaqen e parcelave të lartcekura, sipërfaqja ndërtimore kompensuese, do të jetë: **S=609 x 1.8=1,096.20m².**

Sipërfaqet e sakta të pjesëve të parcelave kadastrale për kompensim / shpronësim me koeficient ndërtimi, do të realizohen-kompensohen në bazë të manualit të matjeve nga gjeometri i licencuar dhe pas verifikimit të Drejtorisë për Pronë e Komunës së Prishtinës.

Procedura e kompensimit të pronës private me koeficient ndërtimi duhet të kryhet në fazën pas miratimit të kushteve ndërtimore dhe para aplikimit për leje ndërtimi, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, bazuar në Vendimin 01nr.031-185483 të datës 14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me marrëveshje paraprake të aprovuar dhe nënshkruar nga Drejtoria e Urbanizmit.

VII. Bashkimi i parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale, nr. 1830-1, 1830-2, 1830-3, 1830-4, 1830-11,1830-12 & 10204-1 ZK Prishtinë, do të bëhet sipas riparcelimit dhe formimit të **Parcela ndërtimore "E11-1"**, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe Manualit të bashkimit të parcelave, punuar-propozuar nga Kompania gjeodezike "GeoHorizont"sh.p.k. nga Prishtina me licencë nr.54.

Andaj, drejtoria jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR " Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe manualit për bashkim.

Procedura e bashkimit do të realizohet pas realizimit të proceduarave të paragrafit VII. të vendimit të kushteve ndërtimore dhe bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operetën kadastrale, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarëve & investitorit, si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues " Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkimit punuar nga Kompania gjeodezike e licencuar GeoHorizont"sh.p.k. nga Prishtina me licencë nr.54.

VIII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

IX. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, *"Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor",* bazuar në UA i MMPH-së Nr.33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshitë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të zhvilluara në terren;

X. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për **Masat e mbrojtëse nga zjarri** hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;*

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*
- *Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*
- *Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.*

Dokumentacioni ndërtimor- Elaborati për **Leje Mjedisore Komunale** hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;*
- *Certifikatën për regjistrimin e biznesit;*
- *Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;*

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XI. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale nr. 1830-1, 1830-2, 1830-3, 1830-4, 1830-11 & 1830-12 ZK Prishtinë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "Arë e klasit 4" dhe "Rrugë" paraprakisht kërkohet të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, <u>për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore</u>, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej <u>S=3728m²</u>. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XII. Pagesa e taksës për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XIII. Vlefshmëria e kushteve ndërtimore është një (1) vit, me të drejtë vazhdimi edhe për një (1) vit tjetër, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së kushteve ndërtimore.

A r s y e t i m

Kërkuesit/pronarët, Isa Berisha, Ymrane Pangja, Avni Berisha, "Prime Group Construction" sh.p.k, Kujtim Thaçi, nga Prishtina dhe Investitorit "Prime Group Construction" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810046781 dhe me përfaqësues Teki Bujupi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr. 350 /02 - 224787/19 dt.12.09.2019, kanë kërkuar nga kjo drejtori, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për ndërtimin e **Kompleksi *"Prime City 04"*,** me ndërtesa shumë banesore & afariste –

